



Financuar nga
Bashkimi Evropian



REKOMANDIME

Tryezë

Ecuria e adresimit të rekomandimeve të Raportit të Komisionit Europian 2025 sa i përket fushës së sigurisë ushqimore dhe sfidat sa i përket plotësimit të angazhimeve në kuadër të procesit të negociatave në Grupkapitullin 5 “Burimet, Bujqësia, Kohezioni”/ Kapitulli 12

**E mërkurë, 4 shkurt 2026, ora 11:30
Salla e Grupeve Parlamentare, Kuvendi i Shqipërisë**

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me **Këshillin Kombëtar të Integritimit Europian (KKIE)** diskutuan në këtë tryezë, me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile, ekspertë, përfaqësues të medias e akademisë, ecurinë e përmbushjes së piketave përmbyllëse të **Kapitullit 12 – Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve**, si dhe të gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit të Komisionit Europian për vitin 2025, duke adresuar progresin e Shqipërisë në përafrimin me *acquis* të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe sistemeve të kontrollit zyrtar.

a) Gjatë diskutimeve u sollën këto rekomandime të vlefshme për t’u konsideruar në vazhdim në lidhje me kuadrin ligjor dhe zbatimin:

1. Masa të menjëhershme duhet të ndërmerren për zbatimin efektiv të **150 akteve prioritare**, të cilat përbëjnë boshtin funksional të sistemit të sigurisë ushqimore dhe janë thelbësore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Europian. Këto akte nuk duhet të trajtohen thjesht si piketa formale përmbyllëse, por si instrumente reale që duhet të jenë plotësisht të zbatueshme **përpara momentit të anëtarësimit**, pasi pas këtij momenti Bashkimi Europian e aplikon sistemin në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa bërë asnjë dallim mes vendeve anëtare, pavarësisht madhësisë apo nivelit të zhvillimit.
2. Aktualisht, procesi i përafrimit të legjislacionit po realizohet kryesisht në mënyrë të pjesshme, dhe jo përmes një transpozimi të plotë dhe koherent të *acquis* edhe me akte nënligjore. Kjo qasje fragmentare krijon paqartësi në zbatim, mbivendosje kompetencash dhe dobëson efektivitetin e kontrollit zyrtar. Fakti që rekomandimet e Komisionit Europian mbeten të pandryshuara prej vitesh dëshmon qartë se problematikat janë strukturore dhe kërkojnë ndërhyrje të thelluara, jo masa të përkohshme.

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



REKOMANDIME

3. Auditimet e fundit të Komisionit Europian të zhvilluara në Shqipëri kanë nxjerrë në pah problematika serioze përgjatë gjithë zinxhirit të sigurisë ushqimore, duke dëshmuar se kapacitetet e institucioneve ligjzbatuese nuk janë në nivelin e kërkuar. Situata bëhet edhe më shqetësuese nga fakti se, edhe në rastet kur institucionet kanë kryer inspektime paraprake dhe kanë lënë detyra konkrete për t'u përmbushur nga operatorët e biznesit ushqimor, pas përmbushjes formale të këtyre detyrave janë konstatuar sërish shkelje dhe mangësi thelbësore. Kjo tregon se problematika nuk qëndron vetëm te mungesa e zbatimit, por edhe te **cilësia e vetë inspektimit dhe rekomandimeve të dhëna**, çka cenon besueshmërinë e sistemit. Përgjashtim pozitiv përbën sektori i veterinarisë, i cili ka marrë vlerësime të mira në auditimet e fundit, duke treguar se kur kapacitetet janë ndërtuar siç duhet, rezultatet janë të prekshme. Për arsyet e përmendura më sipër, reforma e inspektorateve duhet të përshpejtohet ndjeshëm, pasi vonesat e deritanishme kanë krijuar një handicap të qartë institucional, i cili rrezikon jo vetëm procesin e integritetit, por edhe sigurinë reale të konsumatorit shqiptar.
4. Përveç përmirësimit të kuadrit ligjor, është e domosdoshme të kryhet një **analizë reale në terren e sektorit të bujqësisë**, duke e ndarë atë sipas degëve. Kjo analizë duhet të identifikojë problematikat kryesore, si konkurrencën e pandershme me vendet e tjera dhe sfidat specifike të secilës degë, për të mundësuar politika efektive mbrojtjeje dhe zhvillimi të sektorit.
5. Për të garantuar cilësinë e produkteve, duhet të **ngrihen pika të grumbullimit** në çdo fshat, të standardizuara sipas rregullave të cilësisë, duke krijuar lidhje të drejtpërdrejta mes fermerit dhe prodhuesit. Kjo qasje eliminon nevojën për periudha tranzitore për industrinë e përpunimit dhe siguron standarde uniforme për të gjithë sektorin.
6. Pa funksionalizimin e **kontratave** ndërmjet fermerëve dhe industrisë së përpunimit nuk mund të arrihet siguria ushqimore. Kontrata mes fermerit për grumbullimin dhe fabrikës për përpunimin nuk mund të funksionojë nëse nuk mbështetet ligjërisht dhe nëse nuk shoqërohet me mekanizma arbitrazhi. Duhet të mendohet seriozisht për ngritjen e arbitrazhit, pasi jo të gjitha ankesat mund të zgjidhen përmes mekanizmave ekzistues, veçanërisht në një sistem të bazuar në kontrata.

b) Rekomandime në lidhje me kuadrin institucional:

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



REKOMANDIME

1. **Duhet të ngrihet një strukturë e posaçme pranë ministrisë ose një drejtori e dedikuar për çështjen e kooperimit.** Me ndihmën e Këshillit të Agrobiznesit janë krijuar 104 shoqëri bujqësore bashkëpunimi (SHBB), të cilat janë regjistruar në QKB, por të gjitha janë ndëshkuar me gjopa administrative për arsye të ndryshme dhe aktualisht nuk funksionojnë. Këto gjopa, edhe në rastet e mirëbesimit, duhet të shqyrtohen si mundësi për falje, pasi interesi kryesor është veprimtaria e tyre, si dhe funksionimi i klasterëve dhe formave të tjera të organizimit.
2. Është evidentuar se QKB-ja aktuale nuk ka kapacitet të ndjekë rreth 200 mijë biznese/fermerë. Për këtë arsye, ngritja e një qendre të posaçme regjistrimi, pranë AZHBR-së ose si strukturë e veçantë, është një domosdoshmëri.

c) Rekomandime në lidhje me funksionimin e kontrollit zyrtar dhe gjurmueshmërisë:

1. Zbatimi efektiv i sigurisë ushqimore nuk mund të përballohet nga një institucion i vetëm. Institucione si AKU, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, edhe pse kanë role të rëndësishme, nuk janë në gjendje ta mbajnë të vetme këtë barrë. Për këtë arsye, është e domosdoshme ngritja e **task-forcave dhe grupeve të përhershme ndërinstytucionale**, me kompetenca të qarta, përgjegjësi të matshme dhe mekanizma monitorimi. Këto struktura duhet të funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe jo sporadike, duke garantuar reagim të shpejtë ndaj problematikave dhe një qasje të unifikuar në gjithë territorin.
2. Kontrollat zyrtare përfshijnë jo vetëm aktin e inspektimit, por gjithë sistemin e kontrollit dhe infrastrukturën mbështetëse. Një nga hallkat më të dobëta të këtij sistemi mbetet gjurmueshmëria dhe mungesa e një linje të pandërprerë kontrolli. Prandaj, kontrolli **“nga ferma në tavolinë”**, veçanërisht për produktet me origjinë shtazore, është thelbësor. Funksione të kontrollit ushtrohen nga pushteti vendor para dhe pas thertores, duke e copëzuar linjën e kontrollit zyrtar. Ky fragmentarizim është një nga arsyet kryesore pse Shqipëria ende nuk arrin të eksportojë produkte me origjinë shtazore në BE, pavarësisht marrëveshjes ekzistuese që prej vitit 1991, ku Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje bilaterale për eksportet në Bashkimin Evropian.
3. Krijimi i një **Plani Shumëvjeçar Kombëtar të Kontrollit** është një element kyç për funksionimin e sistemit të sigurisë ushqimore, pasi ai përcakton **qasjen mbi bazë rrisht**. Në një vend me mbi 20 mijë subjekte që merren me ushqimin, duke filluar nga fermat e deri te përpunuesit, është praktikisht e pamundur dhe joefikase të kontrollohen të gjitha subjektet në mënyrë të barabartë. Qasja mbi bazë rrisht është standard evropian dhe përfaqëson një përdorim racional të burimeve njerëzore dhe financiare. Plani shërben gjithashtu si provë dokumentare për

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



REKOMANDIME

Komisionin European se Shqipëria është në gjendje të menaxhojë sistemin e kontrollit zyrtar në mënyrë profesionale dhe të qëndrueshme.

4. Kontrolli zyrtar krijon kosto të konsiderueshme, si për buxhetin e shtetit ashtu edhe për biznesin. Nga njëra anë, *qeveria* duhet të investojë në përmirësimin e infrastrukturës, kapaciteteve njerëzore dhe laboratorike; nga ana tjetër, *bizneset* duhet të përshtaten me standarde të reja, shpesh duke kryer investime të mëdha. Kjo situatë prek veçanërisht sektorin e qumështit dhe agrobizneset e përpunimit të ushqimit. Për këtë arsye, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të zhvillojë **konsultime të strukturuar paraprake me biznesin**, për të shmangur mbyllje masive dhe pasoja sociale të rënda, pasi shumë subjekte që nuk do të jenë të përshtatura në momentin e anëtarësimit nuk do të kenë mundësi të vazhdojnë aktivitetin.

d) Rekomandime në lidhje me infrastrukturën kombëtare dhe laboratorët:

1. Ndërtimi i një infrastrukture kombëtare për trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore kërkon investime të mëdha, duke përfshirë kapacitete laboratorike, impiante për përpunimin dhe magazinimin e sigurt, si dhe rrjete transporti të specializuara. Ky problem prek si aspektin mjedisor, duke parandaluar hedhjen e papërpunuar të nënprodukteve në mjedis, ashtu edhe aspektin e sigurisë ushqimore, duke parandaluar rreziqet e mundshme për shëndetin publik. Për këtë arsye, **duhet të ketë një qasje ligjore të qartë dhe të unifikuar**, që të rregullojë njëkohësisht nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet e mbrojtjes së bimëve, duke përcaktuar përgjegjësitë e qarta të institucioneve, standardet e trajtimit dhe procedurat e kontrollit.
2. Megjithatë, për sa më sipër zbatimi i ligjit kërkon investime konkrete në terren, për të cilat është e nevojshme të planifikohet financim i qëndrueshëm, përfshirë mbështetje nga Bashkimi Evropian dhe donatorët ndërkombëtarë. Duke qenë se një infrastrukturë kombëtare është e vështirë për t'u aplikuar, një **model rajonal bashkëpunimi** me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor do të ishte një nismë strategjike, duke lejuar përdorim optimal të kapaciteteve ekzistuese dhe ulje të kostove të investimeve.
3. Një sfidë tjetër e rëndësishme mbetet **cilësia e auditimeve dhe kontrollit zyrtar**, veçanërisht në pikat e inspektimit kufitar. Edhe pse kontrolli në terren kryhet nga

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



REKOMANDIME

institucionet shtetërore dhe mund të rezultojë në përputhje me standardet, në momentin që produkti mbërrin në kufi, ai mund të bllokohet për arsye të ndryshme: dokumentacioni i paplotë ose i gabuar; shkelje gjatë inspektimit; analizat laboratorike të pasigurta ose të papranueshme nga autoritetet kufitare të vendeve të tjera. Këto mangësi ndalojnë zbatimin e plotë të sigurisë ushqimore dhe rrisin riskun e bllokimit të produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Për këtë arsye, **është e domosdoshme një standard i verifikueshëm dhe i unifikuar i auditimit**, i cili duhet të zbatohet në të gjithë zinxhirin, nga ferma te pika kufitare.

4. Për më tepër, përvoja e Bashkimit Evropian tregon se nivelet e sigurisë ushqimore dhe qasjet ndaj kontrollit ndryshojnë nga vendi në vend. Një shembull është Kroacia, e cila në procesin e anëtarësimit la pa punë gjysmën e prodhuesve të qumështit për shkak të standardeve të paplotësuar. Ky fakt tregon se shteti nuk mund t'i zgjidhë të gjitha problemet për prodhuesit, por ka detyrimin të sigurojë që institucionet e tij të funksionojnë me efikasitet, duke garantuar standarde të larta të kontrollit, monitorimit dhe verifikimit të produkteve.
5. Laboratorë të fuqizuar duhet të operojnë jo vetëm nga ISUV-i (numërohen 7 aktualisht), por çdo drejtori rajonale duhet të ketë të paktën një laborator funksional, i cili nuk kufizohet vetëm tek testet e akredituara; për të garantuar kapacitet të mjaftueshëm testimi dhe verifikimi të produkteve.
6. Kategoria e prodhuesve që prodhojnë vetëm për vetëkonsum dhe për blegtorinë e tyre dhe ata që prodhojnë për vetëkonsum dhe blegtorinë, por që u mbetet edhe një sasi për treg, duhet të jenë të prioritetizuar pasi jo vetëm përbëjnë shumicën, por produktet e këtyre subjekteve janë të domosdoshme për fazën që vjen, veçanërisht për sektorin e turizmit, pasi nuk mund të përballohen nevojat e bujtinave, agroturizmit dhe shumëllojshmërisë së produktit pa to. Prandaj, është e nevojshme të merren masa konkrete për t'i futur ato në procese kooperimi.
7. **Financimi i këtij sektori është thelbësor**, përfshirë rishikimin e çështjes së TVSH-së dhe rimbursimin e duhur për këtë grup fermerësh. Megjithatë, problemi i fermerëve të formalizuar mbetet ende i pazgjidhur dhe kërkon vëmendje të veçantë.

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*



Financuar nga
Bashkimi Evropian



REKOMANDIME

8. **Janë zhvilluar trajnime të vazhdueshme nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)**, por jo për drejtuesit e SHBB-ve, klasterëve dhe grupeve të veprimit. Për këtë arsye, është e domosdoshme ndërtimi i një kurrikule të posaçme në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, në mënyrë që drejtuesit e këtyre strukturave të jenë të kualifikuar dhe jo të orientuar sipas modeleve të ish-kooperativave.
9. **Mekanizimi dhe dixhitalizimi janë të domosdoshme**, duke pasur parasysh se duhet të menaxhohen rreth 1.8 milion parcela. Pa një strategji të qartë për dixhitalizimin, kjo është e pamundur, dhe afatet e përcaktuara aktualisht janë jashtë çdo limiti të arsyeshëm dhe duhet të përshpejtohen.

e) Rekomandime në lidhje me ndërgjegjësimin:

1. Opinioni publik shpesh ka një perceptim të gabuar ndaj produktit vendas, duke preferuar produktet e importit, të cilat nuk janë gjithmonë më të sigurta. Për këtë arsye, duhet të ndërtohet **besim i qëndrueshëm tek produkti vendas** përmes institucioneve të besueshme të kontrollit; laboratorëve cilësorë të testimit dhe trupave të inspektimit të trajnuar dhe të paanshëm.
2. Një nivel i lartë besueshmërie institucionale kërkon që **memoria institucionale** e inspektorëve të trajnuar të ruhet. Kjo do të thotë që punonjësit kyç të mos largohen nga puna pa shkaqe të justifikuara, pasi eksperiencia dhe njohuritë e tyre janë thelbësore për zbatimin efektiv të standardeve të sigurisë ushqimore.

**Kjo tryezë u zhvillua në kuadër të projektit “Linja e gjelbër për mbrojtjen e konsumatorit – Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”, financuar nga Bashkimi Evropian (IPA III/2024), që po zbatohet nga Qendra Alert në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).*